



Kuvendi i Komunës së Deçanit

01.Nr.II

Deçan, dt.06.06.2024

Në bazë të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bën këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e VII-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e II-të e jashtëzakonshme (në vitin 2024) e Kuvendit të Komunës së Deçanit, e cila do të mbahet me dt.11.06.2024 /e marte/ në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë:

### Rend pune

1. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj dhe marrja e Vendimit për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, Dr.Mentor Petrela.

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. \_\_\_\_ /2024

Dt. 06 / 06 /2024

Për/To/Za:	Z. Hajdar Sutaj – Kryesues i Kuvendit Komunal – Deçan Anëtarët e Kuvendit Komunal
Nga/From/Od:	z. Bashkim Ramosaj – Kryetar i Komunës së Deçanit
Përmes/Through/Preko:	
Tema/Subject/Subjekat:	Propozim-Vendim për shpallje “Qytetar Nderi” Dr. Mentor Petrela

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

Duke u bazuar në nenin 58 pika h) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale NR. 03/L-040 dhe nenit 56 pika 8 të Statutit të Komunës së Deçanit, propozoj që të merrni vendimin për shpalljen e Dr. Mentor Petrela - “ QYTETAR NDERI” i Komunës së Deçanit.


Me motivacionin;

“Për kontributin e tij në fushën e shëndetësisë, e në veçanti për ndihmën dhe angazhimin e tij ndaj qytetarëve të Komunës së Deçanit”

Dr. Mentor Petrela është një ndër neurokirurgët më të mirë jo vetëm në Shqiptari, por në gjithë botën. Ai është krenaria e shqiptarëve kudo, jo vetëm mjeku ynë por i gjithë botës. Dr. Petrela na ka nderuar kudo në botë.

Të nderuar Asambleistë, kërkoj nga ana juaj ta mbështetni propozimin tonë dhe të na jepni mundësinë që ta nderojmë për të gjithë veprimtarinë e tij shkencore, profesionale e mbi të gjitha humane”.

Të bashkëngjitur e gjeni edhe një biografi të shkurtër të Dr. Petreles.





### **Biografia e Dr. Mentor Petrela**

Mentor Petrela lindi në Tiranë në vitin 1950, ku e mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për mjeksi i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1973, ku u diplomua “Cum Laude”.

Studimet specialistike i mbaroi në Universitetin Rene-Descartes XI të Parisit, ku u kurorëzua me diplomën në fushën e neurokirurgjisë në vitin 1979.

Në vitet 1990-1996 ishte shef i Shërbimit të Neurologjisë dhe Neurokirurgjisë të Qendrës Spitalore “Nëna Tereza”, ndërsa në vitet 1993-1997 ishte Drejtor i Përgjithshëm i kësaj Qendre Spitalore.

Nga viti 1994 është profesor i Neurokirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës. Në vitet 1995-2000 ishte President i Shoqatës Shqiptare të Neurologjisë, ndërkaq nga viti 1996 ushtroi funksionin e Shefit të Neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nëna Tereza” në Tiranë. Në viti 1997 zgjidhet President i Shoqatës Shqiptare të Neurokirurgjisë. Në vitet 1999-2002 ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, ndërsa në vitet 2008-2011 ushtroi funksionin e shefit të Departamentit të Neurologjisë dhe Psikiatrisë.

Nga viti 1992 është anëtar nderi i Shoqatës Franceze të Neurologjisë. Në vitin 1996 mori çmimin “Chevalier dans l’Ordre des Palmes Académiques” (“Kalorës i Urdhrit të Palmes Akademike”) nga Kryeministri i Frances Alain Juppé.

Me Konkurs Kombëtar për Universitetet e Frances në vitin 1997 në Paris zgjidhet Profesor i Neurokirurgjisë. Prej vitit 1998 është anëtar i Eorld Federation of Neurological Ssurgery, European Assotiation of Neurological Societies. Ishte anëtar aktiv i Eorld Academy of Neurological Ssurgery me seli në Vienë, ku mbajti dhe ligjërata. Në cilësi të profesorit të ftuar (professeur invite) mbajti ligjërata në Universitetet e Parisit, Milanos, Nju-Yorkut, Gjenevës etj.

Në vitin 2014 Presidenti i Frances Francois Hollande ia dha dekoratën më prestigjioze të Francës “Chevalier de la Legion d’Honneur” (“Kalorës i Legjionit të Nderit”).

Ka botuar punime të shumta shkencore nga fusha e neurokirurgjisë në revista të njohura shkencore dhe përmbledhje studimesh në vende të ndryshme.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> <https://ashak.org/anetaret/mentor-petrela/>